



Procesi i Berlinit - trampolinë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian apo “vendpritjeje” për shtetet kandidate?

Emanuela Skënderi

Hyrje

Samiti i fundit i Procesit të Berlinit, i mbajtur për herë të parë në një vend të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri), e ka rikthyer atë në vëmendjen e rajonit dhe Bashkimit Evropian. Procesi i Berlin është një nismë e iniciuar në vitin 2014 nga kancelaria gjermane e asaj kohe, Angela Merkel, por që pas largimit të saj u ngritën dyshime mbi vazhdimësinë e tij.

Ky shkrim përpiket të shtjellojë nëse Procesi i Berlinit e përshpejton anëtarësimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian (BE) apo krijon një vendpritje të përhershme. Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shoqëritë e tyre kryesisht kanë një qasje pozitive lidhur me anëtarësimin në BE pas integrimi në BE shihet si mënyra më e dobishme për zhvillimin e tyre ekonomik, politik, dhe shoqëror. Në këtë kuadër, Procesi i Berlinit, nismë e Gjermanisë por e mbështetur nga vendet e tjera të BE-së si Austri, Francë, Itali etj (Procesi i Berlinit, arritjet dhe sfidat, 2022), synon përgatitjen e vendeve të rajonit për anëtarësim duke rritur fillimisht bashkëpunimin brenda rajonit.

Me synim për të trajtuar pyetjen e lartpërmendur, në këtë punim do të trajtohet ecuria e Procesit të Berlinit dhe bashkëpunimi rajonal, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dypalëshe, Agjenda e Gjelbër, periudha e stanjacionit, dhe ripërtëritja e procesit.



Konteksi i përgjithshëm

Integrimi i vendeve të Ballkanit lidhet me përafrimin dhe përgatitjen e kornizës ligjore, institucionale dhe politikbërëse sipas 33 kapitujve. Stadi i gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor është i ndryshëm pasi Mali i Zi dhe Serbia kanë përparuar me bisedimet për anëtarësim, Shqipëria dhe Maqedonia sapo kanë hapur negociatat, Bosnja-Hercegovina është tashmë vend kandidat, ndërsa Kosova është kandidat potencial për anëtarësim.

Në vitin 2014 BE ndryshoi kursin e politikës së zgjerimit duke priorizuar nevojën e BE-së për tu reformuar e konsoliduar fillimisht së brendshmi. Ky qëndrim solli zhgënjim në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në një situatë të tillë, Procesi i Berlinit ishte gjetje politike e Kancelares Merkel për të mbajtur rajonin të angazhuar në agjendën e reformave. Vendet e Ballkanit Perëndimor e përqaftuan këtë nisëm duke e konsideruar angazhimin në të një hap më afër synimit fundor të intergrimit në BE.

Fillimet ishin shpresëdhënëse pasi takimet vjetore mes krerëve qeveritarë përcollën një qasje më bashkëpunuese rajonale. Faza e parë e Procesit të Berlin nisi me Konferencën e Shteteve të Ballkanit Perëndimor të vitit 2014 në Berlin dhe u pasua nga Samiti i Vjenës 2015, Samiti i Parisit 2016 dhe Samiti i Triestes 2017 (Zoran Nechev, 2018). Qëllimet e Procesit u përshkruan në Deklaratën Përfundimtare në vitin 2014: *“Për të bërë progres shtesë real në procesin e reformave, në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura dypalëshe dhe të brendshme, dhe në arritjen e pajtimit brenda dhe ndërmjet shoqërive në rajon”*. Procesi i Berlinit vendosi theksin tek bashkëpunimi rajonal me nënshkrimin e deklaratës për adresimin e mosmarrëveshjeve dypalëshe dhe çështjeve të shtetësisë, krijimin e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor, krijimin e Tregut Rajonal të Përbashkët dhe Planit Shumëvjeçar të Zonës Ekonomike Rajonale, duke nxitur në këtë mënyrë marrëdhëniet ndërmjet agjentëve të ndryshëm shoqëror (Procesi i Berlinit dhe sfidat e integrimit në BE të vendeve të Ballkanit, 2023).

Ecuria e Procesit të Berlinit nuk ka qenë e njëtrajtshme, siç reflektohet dhe nga vetë nga raportet e Forumit të Shoqërisë Civile Samitit të vitit 2023. Nga fillimi nëntë vite më parë, vërehet se procesi shpesh ka patur ritëm të ngadaltë. Kësisoj, ky punim do trajtojë arritjet dhe pengesat që ka hasur Procesi i Berlinit.



Arritjet dhe pengesat e Procesit të Berlinit

Ballkani është cilësuar si një “fuqi baruti” ku konfliktet mes vendeve mund të rindizen dhe të përshkallëzojnë deri në agresion. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë nuk i ka shuar plotësisht konfliktet mes këtyre vendeve, siç evidentohet nga marrëdhënia mes Kosovës dhe Serbisë, ku ky i fundit mohon njohjen e Kosovës si shtet i pavarur. Ama, Procesi i Berlinit ka një meritë të konsiderueshme në uljen e të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor në një tryezë të përbashkët. Duke patur parasysh se Procesi i Berlinit është një platformë joformale e procesit të anëtarësimit, e lehtësoi pjesëmarrjen e vendeve duke garantuar gjithëpërfshirjen.

Një ndër sukseset e Procesit të Berlinit është Zyra e Bashkëpunimit Rajonal Rinor (RYCO-s) e cila synon të promovojë frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit midis të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit. Marrëveshja për themelimin e RYCO-s u nënshkrua nga Kryeministrat e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë Samitit të mbajtur në Paris në vitin 2016. Që prej themelimit, RYCO ka mbështetur mbi 100 projekte, ka fuqizuar më shumë se 31,000 të rinj, duke investuar mbi 7 milionë euro në programet e shkëmbimit të të rinjve, në nivel rajonal dhe lokal, dhe ka mbështetur rreth 240 organizata të shoqërisë civile dhe 115 shkolla (Marini, 2021). Përsa i përket bashkëpunimit rajonal ndërmjet universiteteve dhe institucioneve kërkimore, raportet tregojnë rritje të studiuesve të Ballkanit Perëndimor në programet kërkimore të BE-së.

Angazhim tjetër i rëndësishëm i Procesit të Berlinit është plani për një Treg të Përbashkët Rajonal (CRM) në fushat tregtare, digjitale, indistruale dhe inovative. Por deri tani, plani CRM ka çeduar si pasojë e mosmarrëveshjeve dypalëshe (Kosovë-Serbi), pengesave politike dhe mangësive financiare. Shoqëria civile shpesh ka propozuar se Komisioni Evropian duhet të paraqesë një plan për të lejuar tregjet e Ballkanit Perëndimor të aksesojnë tregun e përbashkët të BE-së në fushat që nuk kanë kosto të larta rregullimi. Gjithashtu, është theksuar rëndësia e rritjes së financimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor duke parë që buxheti ka mbetur i qëndrueshëm në rreth 10 miliardë EUR për çdo periudhë 7 vjeçare (Blerjana Bino, 2023).



Agjenda e Gjëlber është tjetër element i rëndësishëm i Procesit të Berlinit që synon përafrimin me objektivat e Marrëveshjes së Gjëlber Evropiane. Vendet e Ballkanit Perëndimor kryesisht janë në fazat fillestare të përgatitjes përsa i përket kapitullit 27 të *acquis* - Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike - sipas raporteve të fundit të Komisionit Evropian. Mungesa e fondeve për financimin e infrastrukturës së gjëlber qëndron sfida kryesore për vendet e Ballkanit. Për të përmbushur standartet e kapitullit 27, Mali i Zi vlerëson të nevojshme 483 milionë EUR, Serbia 12 miliardë EUR, Maqedonia e Veriut 1.2 miliardë EUR, ndërsa Shqipëria 3,5 miliardë EUR (Ivanova, 2023). Në lidhje me këto nevoja, shoqëria civile ka rekomanduar adresimin e nevojave financiare të vendeve të Ballkanit Perëndimor në arritjen e pajtueshmërisë me *acquis* të BE-së dhe kalimin drejt një shoqërie neutrale ndaj karbonit.

Stanjacioni dhe ripërtëritja e Procesit të Berlinit

Në vitin 2019, u ngritën shqetësime nëse Procesi i Berlinit po përshpejton në mënyrë të kënaqshme ritmin e integritimit në BE. Ky skepticizëm u shpreh nga vetë vendet e Ballkanit Perëndimor përmes nismës Ballkani i Hapur. Kjo nisëm lindi në takimin e tetorit 2019 mes tre Kryeministrave të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Kjo nismë me karakter ekonomik kishte qëllim arritjen e marrëveshjeve mbi zbatimin e lëvizjes së lirë të mallrave, kapitalit, njerëzve dhe shërbimeve (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme).

Ballkani i Hapur krahasimisht me Procesin e Berlinit ndante të njëjtat parime për të përshpejtuar integritimin në BE por nuk pati qasje gjithëpërfshirëse. Kosova e kundërshtoi duke e konsideruar nismën kthim pas, ku Serbia do impononte interesat e saj. BE pati një qëndim diplomatik të heshtur pasi presidentja e Këshillit Evropian Von der Leyen tha se nisma e tilla bashkëpunuese brenda Procesit të Berlinit mirëpritën.

Vazhdimësia e Ballkanit të Hapur çdo ditë duke mos pasur përfshirjen e gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe zhvillimet në arenën ndërkombëtare risollën nevojën e ripërtëritjes së Procesit të Berlinit. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës ishte pikë-kthesë për BE-në për të risjellë Procesin e Berlinit. Realiteti i ri gjeopolitik diktoi garantimin e sigurisë rajonale në Ballkan, duke e cilësuar se BE pa Ballkanin Perëndimor është i paplotë.



Kancelari aktual Scholz u shpreh se Procesi i Berlinit nuk kishte çliruar gjithë potencialin e tij dhe bëri thirrje për një ritëm të ri të procesit të anëtarësimit. Frytet e para ishin nënshkrimi i tre marrëveshjeve që lehtësojnë lëvizshmërinë nga vendet e rajonit që sinjalizoi zhblokimin e Procesit të Berlinit (Bushati, 2022). Pas një periudhe të gjatë negociatash, vendet arritën marrëveshje që do të lehtësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve në të gjithë rajonin dhe njohjen reciproke të kualikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve.

Përfundime

Në fund duhet theksuar se Procesi i Berlinit u krijua për të nxitur bashkëpunimin rajonal, fqinjësinë e mirë dhe për të lehtësuar integrimin e vendeve të Ballkanit në BE. Ecuria e procesit të Berlinit ka pasur ulje dhe ngritje por ka sjellë disa projekte të dobishme si Zyra e Bashkëpunimit Rajonal Rinor, plani për një Treg të Përbashkët Rajonal, dhe Agjenda e Gjelbër. Nisma e Ballkanit të Hapur sinjalizoi pakenaqësitë e vendeve të Ballkanit me ritmin e hapave drejt BE-së. Së fundmi, BE dhe rajoni janë përkushtuar fuqimisht në Procesin e Berlinit. Pavarësisht pengesave, Procesi i Berlinit mbetet platforma më e sigurt dhe gjithëpërfshirëse për Ballkanin Perëndimor drejt integritit në BE.

Referenca

Blerjana Bino, A. D. (2023, october). Retrieved from Key Recommendations of the Mobility Thematic Working Group on Mobility

Bushati, D. (2022, November). Retrieved 2023, from RIPËRTËRITJA E PROCESIT TË BERLINIT

Ivanova, T. P. (2023, october). Retrieved from Key Recommendations of the Thematic Working Group on Climate and Green Agenda

Kacarska, S. R. (2023, october). Retrieved from Key Recommendations of the Thematic Working Group on Access to European Single



Institute
for Democracy
and Mediation



Hanns
Seidel
Stiftung

Marini, M. (2021). Retrieved from Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe BE mbështesin projekte të reja: <https://ata.gov.al/2021/02/24/zyra-rajonale-per-bashkepunim-rinor-dhe-be-mbeshtesin-projekte-te-reja/>

Ministria per Evropën dhe Punët e Jashtme . (n.d.). Retrieved from Nisma “Open Balkan-Ballkani i Hapur”: <https://punetejashtme.gov.al/nisma-open-balkan-ballkani-i-hapur/#>

Procesi i Berlinit dhe sfidat e integritit në BE të vendeve të Ballkanit. (2023, 28 SEPTEMBER). Retrieved from ZERI I AMERIKES: <https://www.zeriamerikes.com/a/7288177.html>

Procesi i Berlinit, arritjet dhe sfidat. (2022). Retrieved from DW: <https://www.dw.com/sq/samiti-i-procesit-t%C3%AB-berlinit-arritjet-dhe-sfidat/a-63646360>

THE EUROPEAN FUTURE OF THE WESTERN BALKANS. (2023, OCTOBER 15). Retrieved from OPEN SOCIETY FOUNDATION: https://wb-csf.eu/docs/01_Key-Recommendations-of-the-Thematic-Working-Group-on-Access-to-European-Single-Market.pdf.pdf

The Western Balkans and the Berlin Process. (2018, july). Retrieved from https://www.sant.ox.ac.uk/sites/default/files/berlin_process_workshop_report_v2.pdf

Zoran Nechev, G. M. (2018). Retrieved from The Berlin Process.What worked and what did not work?And why?: <https://mail.google.com/mail/u/0/#sent?projector=1>